



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 3, pika 3.1, shkronjat **b** dhe **h** të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, për ndryshimin e Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenit 2 të Rregullores mbi dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme shoqërore që administrohet nga komunat e Kosovës nr. 2005/13, dhe të nenit 16 paragrafi 16.1, shkronjat **b** dhe **h** të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31. 3. 2008, miratoi

V E N D I M
MBI DESTINIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË
AMBASADËS SË SHBA-SË NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për destinimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrave kadastrore nr. 7183, 7184, 7185, 7186, 7187 dhe 7506, të evidencuara në fletën poseduese nr.4137, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 5.80.00 ha, në pronësi komunale.

Neni 3

Lokacioni nga neni 1 i këtij Vendimi, do t' u jepet në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA-së) me destinim për ndërtimin e Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, pas përmbushjes së procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut 2005/13.

Dhënia në shfrytëzim e lokacionit, sipas par. I të këtij neni, do të bëhet pa kurrfarë kompensimi material apo forme tjetër të obligimit.

Neni 4

Destinimi i caktuar i lokacionit sipas këtij Vendimi, do të jetë pjesë e Planit rregullues të lagjes “Arbëria 3” në Prishtinë.

Neni 5

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv për të cilin është destinuar lokacioni sipas këtij Vendimi, si dhe bazë juridike për evidencimin e këtij lokacioni në emër të shfrytëzuesit, nga neni 3 i këtij Vendimi, në evidencat kadastrore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Prishtinës. Drejtorja e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit e Komunës së Prishtinës dhe drejtoritë tjera komunale, do t'i kryejnë veprimet nga përgjegjësitë e tyre të caktuara me ligj për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 46-378, më 03.04.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa